

□

LËNDA:

Rregullat zyrtare
të lojës shpërblyese "Ditëlindja e 12-të e Ramstor!"

Neni 1

EMRI ZYRTAR I LOJËS SHPËRBLYESE

Emri zyrtar i Lojës shpërblyese është "Ditëlindja e 12-të e Rasmtor!"

Organizues i lojës shpërblyese: Ramstor Maqedoni SHPK, me seli në rr. Shën Qirili dhe Metodij nr.13, Shkup (në tekstin e mëtejme Organizuesi).

Neni 2

KOHËZGJATJA E LOJËS SHPËRBLYESE

Loja shpërblyese do të organizohet në periudhën prej 05.10.2017 -
23.11.2017

Neni 3

QËLLIMI I LOJËS SHPËRBLYESE / ORGANIZUESI

Qëllimi i kësaj loje shpërblyese është reklamimi i shërbimeve të organizuesit.

Neni 4

PËRSHKRIMI I LOJËS SHPËRBLYESE

Neni 4.1

Territori i lojës shpërblyese

Loja shpërblyese do të realizohet në të gjitha Ramstore marketët në Shkup, Tetovë, Kumanovë, Kërçovë, Ohër, Strugë, Strumicë në këto adresa:

Marketët	Adresa
Vardar	rr. Qiroli dhe Metodij nr. 13, Shkup
Kapitol	Bul. Jane Sandanski nr.71, Shkup
Çair	rr. Georgi Pophristov nr. 2, Shkup
Lisiçe e Re	Bul. Vidoe Smilevski-Bato nr. 10a, Shkup
Lisiçe e Epërme	rr."Fevruarski pohod" 46 – Aerodrom, Shkup
Kapishtec	rr. Vasil Gjorgov nr. 20a, Shkup
Kisella Vodë	rr. Boris Trajkovski nr. 64, Shkup
Kuvendi	rr. Dame Gruev nr. 1, hyrja 1, Shkup
Vodno	rr. Todor Aleksandrov nr. 83, Shkup
Tetovë 1	rr. Mareshali Tito p.n. Palma Mol, Tetovë
Tetovë 2	rr. Mareshali Tito nr. 21 ATA, Tetovë
Tetovë 3	rr. Von Vardarska nr. 1, Tetovë
Kumanovë	rr. Brigada e 3-të maqedonase nr.68, Kumanovë
Ohër	rr. Klimenti i Ohrit nr.1, kompleksi Letnica, Ohër
Strugë	rr. Mareshali Tito nr. 116b, Strugë
Struga ekspres	rr. Brigada proletare nr. 20, Strugë
Debar Maallo	rr. Bllagoj Davkov nr.2-Qendër, Shkup
Aerodrom	rr. Millan Zeçar nr.6, Shkup
Kërçovë	rr. Bulevardi "Oslloboduvanje" nr. 1, Kërçovë
Siti moll	rr. Lujbanska nr.4-Karposh, Shkup
Kumanovë ekspres	rr. Hristijan Todorovski Karposh nr.97, Shkup
Ohër ekspres	rr. Jane Sandanski nr.98A, Ohër
Strumicë	rr. Bllagoj Jankov-Muçeto nr.16, Strumicë

Neni 4.2

RREGULLAT PËR PJESËMARRJE NË LOJËN SHPËRBLYESE

Loja shpërblyese "Ditëlindja e 12-të e Ramstor!" fillon më 05.10.2017 në ora 08:00 dhe përfundon më 23.11.2017 në ora 22:00.

1. Të drejtë për pjesëmarrje në lojën shpërblyese kanë të gjithë blerësit e moshës madhore, llogaritë fiskale të cilëve kanë vlerë prej 1000 denarë e më shumë.

2. Kohëzgjatja e lojës shpërblyese është prej 05.10.2017 deri më 23.11.2017. Në lojën shpërblyese do të marrin pjesë të gjitha llogaritë fiskale të lëshuara në periudhën prej 05.10.2017 deri më 23.11.2017 – prej orës 08:00 deri në ora 22:00.
3. Nëse ekzistojnë llogari fiskale të lëshuara saktë deri në ora 22:00 më 23.11.2017, të njëjtat do të merren parasysh dhe kanë të drejtë për pjesëmarrje nëse paraqiten më së voni deri në ditën e ardhshme, deri në ora 12:00, në info pikët e vendosura në Ramstore marketët, ku do t'u jepen kuponët për pjesëmarrje në lojën shpërblyese.
4. Tërheqja e shpërblimeve do të bëhet më 01.12.2017, e premtë në ora 12:00 në QT Ramstor Moll para marketit, ndërsa do të kontrollohet nga komisioni i përbërë prej një përfaqësuesi të Ramstore dhe noterit.
5. Llogaria fiskale e shfrytëzuar një herë, nuk mund të marre pjesë përsëri në lojën shpërblyese.
6. Fondi i shpërblimeve për periudhën e caktuar është i kufizuar dhe përbehet prej ndarjes së: 1 (një) çmimi kryesor – automjeti Hyundai Tucson dhe 12 vauçerë me vlerë për udhëtim nga Agjencia turistike Savana.
7. Çdo pjesëmarrës në lojën shpërblyese, me vetë pjesëmarrjen pajtohet që nëse tërhiqet për njërin nga shpërblimet, emri dhe mbiemri i tij të publikohet në ueb faqen zyrtare të Ramstore Maqedoni.
8. Shpërblimet mund të merren menjëherë, ndërsa afati i fundit është 60 ditë nga dita e tërheqjes, në zyrat administrative të Ramstore në rr. Shën Qirili dhe Metodij nr.13, Shkup.
9. Shpërblimi i fituar, nuk mund të zëvendësohet me tjetër dhe nuk ekziston kurrfarë kompensimi tjetër.
10. Pjesëmarrësit paraprakisht janë pajtuar me rregullat e lojës shpërblyese.
11. Të gjithë të punësuarit në Ramstor Maqedoni SHPK, si dhe anëtarët e familjeve të tyre më të ngushta nuk mund të marrin pjesë në lojën shpërblyese.
12. Në rast të parregullsisë dhe mos përmbajtjes deri te rregullat e vendosura, organizuesi Ramstor Maqedoni i ruan të drejtat ta diskualifikojë pjesëmarrësin.
13. Mënyra e pjesëmarrjes në lojën shpërblyese:

Hapi 1

Të parashtrohet llogaria fiskale me vlerë të barabartë ose më të lartë se 1000 denarë të shpenzuara në Ramstore marketët në info pikat gjatë së cilës merret kuponi shpërblyes. Kuponi duhet të plotësohet nga ana e konsumatorit me këto të dhëna personale: Emri dhe mbiemri, adresa dhe kontakt telefoni dhe i hedhur në kutitë e shënuara dhe të vendosura në vend të dukshëm në marketë.

Sqarim:

- Për llogari prej 1000 deri 1999 denarë, blerësi fiton një kupon shpërblyes
- Për llogari prej 2000 deri 2999 denarë, blerësi fiton dy kuponë shpërblyes
- Për llogari prej 3000 deri 3999 denarë, blerësi fiton tre kuponë shpërblyes etj. do të thotë për 1000 denarë tjerë fitohet nga një kupon plotësues shpërblyes

Hapi 2

Pas verifikimit të kryer të llogarisë/ve fiskale, personi përgjegjës e dhuron numrin e nevojshëm të kuponëve shpërblyes.

Hapi 3

Konsumatori do të duhet t'i plotësojë të gjitha të dhënat në kuponët shpërblyes, të njëjtat t'i hedhë në kutitë më së voni deri më 23.11.2017 deri në ora 22:00, pas çka kutitë do të mbyllen, dhe t'i ruajë llogaritë fiskale të cekura në kuponin shpërblyes deri në përfundimin e tërheqjes.

Pas mbylljes së kutive të vendosura në çdo Ramstore market, pas çka të gjithë kuponët do të transferohen në një enë të madhe, prej ku do të kryhet tërheqja në Qendrën tregtare Ramstore moll para marketit.

Hapi 4

Më 01.12.2017 në ora 12:00 në Rasmtore Moll, në rr. Shën Qirili dhr Metodij nr.13, Shkup para marketit, do të bëhet tërheqja publike e shpërblimeve në prezencë të komisionit dy anëtarësh të përbërë prej noterit dhe një përfaqësuesi të Ramstore Maqedoni.

Tërheqja do të bëhet me dorë nga ana e një ose dy hostesave.

Neni 4.3

Mënyra e dhënies të shpërblimeve

- Tërheqja do të jetë publike.
 - Tërheqja e shpërblimit kryesor automjet dhe vauçerëve me vlerë do të bëhet më 01.12.2017 në ora 12:00.
 - Në mënyrë plotësuese do të tërhiqen edhe 5 fitues potencial, të cilët do të regjistrohen në listë të veçantë për fitues potencialë plotësues.
 - Nëse ndonjë nga fituesit është i pranishëm në tërheqjen publike, marrja e shpërblimit mund të bëhet menjëherë pas kontrollit të besueshmërisë të dhënave
 - Çdo fitues do të informohet përmes telefonit nga ana e Organizuesit për çmimin e fituar dhe i njëjti mund të merret në afat prej 60 ditëve nga dita e tërheqjes, në zyrat administrative të Ramstore Maqedoni në rr. Shën Qirili dhe Metodij nr.13, Shkup.
 - Pas skadimit të afatit të paraparë, Organizuesi nuk ka kurrfarë përgjegjësie rreth shpërblimeve.
 - Fituesi i shpërblimit gjatë marrjes së shpërblimit duhet të parashtrojë dokument të vlefshëm për identifikim dhe t'i parashtrojë llogaritë fiskale të cekura në kuponin shpërblyes. Nëse gjatë identifikimit të fituesit vërtetohet se nuk i plotëson kushtet për pjesëmarrje në lojën shpërblyese në pajtim me rregullat e cekura, shpërblimi do t'i jepet fituesit tjetër, i cili gjendet në listën e veçantë të fituesve potencial plotësues.
 - Nëse fituesi dhe të gjithë fituesit potencial plotësues e humbin të drejtën për pjesëmarrje në lojë, i njëjti llogaritet se nuk është marrë dhe mbetet në pronësi dhe dispozicion të Organizuesit.
 - Dorëzimi do të bëhet me dorëzimin personal të shpërblimit kryesor dhe shpërblimeve tjera anësore në zyrat administrative të Ramstore Maqedoni. Publikimi i fotografisë ose fytyrës së fituesve të përmbajtura në fotografi, audio ose video incizime ose pjesëmarrje në evenimente publike për qellim të reklamimit të Organizuesit lidhur me lojën shpërblyese, do të jetë lëndë e pëlqimit plotësues të fituesve, për çka fituesit nuk kanë të drejtë për kompensim plotësues.
 - Ramstore do ta paguajë tatimin personal të fituesit.
- Fituesi mund ta transferojë shpërblimin nëse nuk është në mundësi të njëjtin ta shfrytëzojë vetëm te anëtarët e familjes më të ngushtë me deklaratë të

vërtetuar në bazë të cilës përmendet se cili është personi që e transferon të drejtën e shfrytëzimit të shpërblimit.

Si anëtarë të familjes më të ngushtë llogariten: prindërit, vëllai ose motra, fëmijët dhe bashkëshorti/.ja.

- Lista e fituesve do të publikohet në ueb faqen zyrtare të Ramstore Maqedoni www.ramstore.com.mk, menjëherë pas përfundimit të tërheqjes.

Neni 4.4

Përgjegjësia

- Fondi i përgjithshëm shpërblyes do të sigurohet nga organizuesi.
- Organizuesi do të jetë përgjegjës deri në momentin e marrjes së shpërblimeve nga ana e fituesve.
- Me pagesën e tatimit personal dhe marrjen e shpërblimeve, mbeten obligime të mëtejshme të Organizuesit të lojës shpërblyese ndaj fituesve.
- Organizuesi nuk ka kurrfarë përgjegjësie që mund të dale nga shfrytëzimi i shpërblimeve, si dhe pagesa për dëme ose padi të cilat në ndonjë mënyrë kanë të bëjnë me shfrytëzimin e shpërblimeve.

Neni 5

TË DREJTË PËR PJESËMARRJE NË LOJËN SHPËRBLYESE

Të drejtë për pjesëmarrje në lojën shpërblyese ka çdo person fizik i moshës madhore (me 18 vjet të mbushura), përveç personave të cilët janë të punësuar te Organizuesi. Ramstore Maqedoni SHPK dhe anëtarët e familjeve të tyre më të ngushta (prindërit dhe fëmijët, vëllai, motra, bashkëshorti ose bashkëshortja).

Neni 6

NJOFTIMI I PJESËMARRËSVE PËR RREGULAT ZYRTARE

Rregullat zyrtare të lojës shpërblyese pas marrjes së pëlqimit nga Ministria e Financave para fillimit të lojës shpërblyese, do të publikohet në ueb faqen Organizuesit www.ramstore.com.mk, si dhe në pikat informative të çdo Ramstore marketi.

Pjesëmarrësit në Lojën shpërblyese, për rregullat zyrtare të lojës do të mund të informohen përmes materialeve informative-reklamuese të cilat do të

vendosen në vende të dukshme në çdo Ramstore market, mediat e shtypura dhe elektronike (televizione, radio, portale, banerë, posterë, fletëpalosje etj.).

Neni 7

FONDI SHPËRBLYES Neni 7.1 Shpërblimet nga loja shpërblyese

Fondi shpërblyes përbëhet prej:

Emri	VLERA INDIVIDUALE PA TVSH	VLERA INDIVIDUALE ME TVSH	SASIA	VLERA E PËRGJITHSH ME ME TVSH
1. Automjeti Hyundai Tucson			1	
2. Vauçerë me vlerë për udhëtim nga Agjencia turistike Savana		60.000,00	12	
Gjithsej				

*Organizuesi nuk mban përgjegjësi për rregullshmërinë e automjetit që është në barrë të furnizuesit Korea Auro Trejd Shkup, me seli në rr. Skupi nr. 37, Shkup.

Neni 8

OBLIGIMI TATIMOR PËR FITUESIT E SHPËRBLIMEVE

Obligimet tatimore për fituesit e shpërblimeve do t'i paguajë Organizuesi i Lojës shpërblyese në emër dhe për llogari të fituesit.

Neni 9

KONTESTET TË CILAT MUND TË DALIN GJATË LOJËS SHPËRBLYESE

Gjatë Lojës shpërblyese mund të vijë deri te kontesti mes Organizuesit dhe pjesëmarrësve në Lojën shpërblyese. Kontesti mund të ndodhë në rast se ndonjë nga palët e cekura nuk i përmbahet Rregullave zyrtare të Lojës shpërblyese të cilat janë cekur më sipër.

Në rast të cilitdo kontekst mes Organizuesit dhe Pjesëmarrësve në lojën shpërblyese, kontesti i tillë do të zgjidhet në mënyrë paqësore.

Neni 10

AFATI PËR PARASHTRIMIN E ANKESËS

Çdo pjesëmarrës ka të drejtë për ankesë në afat prej 8 ditëve nga dita e përfundimit të lojës shpërblyese.

Organizuesi i Lojës shpërblyese do të përgjigjet ndaj ankesës në afat prej 5 ditëve nga dita e pranimit të njëjtës.

Ramstore Macedonia D00

Menaxher
Ajhan Uzun
